



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2030/ 2 prot.,

Datë: 22.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” , me Nr. REF-74132-07-03-2023 me objekt: “*SERVER + STORAGE NAS PËR SISTEMET E VËZHGIMIT*”, me fond limit 19,975,062 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 20.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A

Ankimues: Operatori ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK.
Adresa: Rruga e Kavajës, kompleksi “Square 21”, sh.2,k.9
me nr. pasurie 1/710+2-30

Autoriteti Kontraktor: ILLYRIAN GUARD SH.A
Adesa: Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë 1016

Në datën 21.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.2030 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3375 e operatorit ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-74132-07-03-2023, me objekt ‘*SERVER+STORAGE NAS PËR SISTEMET E VËZHGIMIT*’ me fond limit: 19975062.0 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.07.2023 nga autoriteti kontraktor, ILLYRIAN GUARD SH.A

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2030/2023 prot., datë 21.08.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3375.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

1.1 Në Serverin e ofertuar në broshurën e serverit nuk ka të përcaktuar kartën grafike e cila në tabelën e specifikimeve teknike SERVER pika (d) kërkohet min 24GB e dedikuar Gen4 ose më e mirë. Në të njëjtën pike janë kërkuar min. 3 porta të cilat mund të jenë DVI, HDMI, DP, mDP, porta të cilat nuk janë të përcaktuara në Serverin e ofertuar nga OE.

1.2 Në Serverin e ofertuar nga OE nuk është shprehur për pikën (e) të specifikimeve SERVER ku kërkohet -Min.1 External USB DVD-RË Optical Disk Drive.

1.3 Në specifikimet teknike Server pika (f) ku kërkohet- Min. 2X1600Ë (230V) hot-sëap nuk është përcaktuar voltazhi i poëer supply 230 V.

1.4 Në specifikimet teknike Server USB pika (h) ku kërkohet- Min 4x porta nga të cilat 2x të jenë porta 3.0 në modelin e ofertuar nga OE nuk është e përcaktuar portat USB .

1.5 Në specifikimet Storage NAS pika (b) Performanca ku kërkohet- Regjistrimi në video Min. (2 Mbps) 600-ch recording + playback në Storage e ofertuar nga OE nuk përmbush funksionalitetin e playback.

1.6 Nga kontrolli në faqen zyrtare te HIK VISION, <https://ëëë.hikvision.com/europe/products/IP-Products/Storage/ClusterStorage/DS-A83048S-ICVS/>, per performancen e Storage te ofertuar DS-A83048S-ICVS pershkruhet se Performanca e ketij storage eshte Standard Cluster (2 Mbps) 430-ch gje qe bie ne kundërshtim me kerkesat ne specifikime teknike ku kerkohet min Min. (2 Mbps) 600-ch.

1.7 Ne Specifikimet teknike Server pika (g) ku eshte kerkuar- PCIe 10Gb 2-Port SFP + Ethernet Adapter ne serverin e ofertuar nuk ka porta PCIe 10Gb SFP+Ethernet adapter.

1.8 Ne specifikimet teknike Server pika (i) VGA ku kerkohet - Min nje porte VGA, modeli i ofertuar nga OE nuk percakton nje porte te tille ne broshuren e Serverit te ofertuar.

Operatori ekonomik nuk plotwson specifikimet teknike.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 22.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri